



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	28.05.2014
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Xhemajl HALILI Drejtor i Prokurimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës
CC:	z. Ismet KRASNIQI Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës "

I nderuari z. HALILI ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës ", me nr. të prokurimit: KU101-14-031-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës " në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Drejtoria e Prokurimit pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull “Renovimi i ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës“ me nr. Prokurimi KU101-14-031-511, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 29.04.2014, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të kësaj procedure të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit , Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me Procedurat e Prokurimit të cilat rregullohen me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, me datë 29.04.2014 dhe dosjen e tenderit, tek rubrika III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2 është kërkuar Qarkullimi për tri vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013) i përcjellë me kontrata dhe referenca për kryerjen ose përfundimin e kënaqshëm të renovimeve dhe punëve të ngjashme. Ndërsa tek pika 2.1. është kërkuar se në rast konzorciumi lideri duhet të ketë jo më pak se 70% të qarkullimit, kërkesa këto në kundërshtim me legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik.

Autoriteti Kontraktues nuk mundet të kërkojë që qarkullimi financiar i Operatorëve ekonomik të dëshmohet me kontrata dhe referenca. Me kontrata dhe referenca mund të dëshmohet natyra e punës, data, vendi apo vlera e punëve, por në asnjë mënyrë nuk lejohet që të vërtetohet qarkullimi financiar.

Kërkesa e cila është caktuar nga Autoriteti kontraktues se në rast konzorciumi lideri duhet të ketë jo më pak se 70 % të qarkullimit është në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 71 të LPP-së. Paragrafi 4 i nenit 71 të këtij ligji përcakton si në vijim, " Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit ".

Paragrafi 4 i nenit 68 të këtij ligji, si dhe paragrafi 8 i nenit 69 të këtij ligji lejon që një operator ekonomik të mbështetet në kapacitetet e subjekteve tjera dhe në këto raste tenderojnë si grup.

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme në dosjen e tenderit AKK ka vërejtur se tek disa pozicione të specifikimeve teknike janë përmendur emra të prodhuesve tek pjesa punët me panel gipsi – knauf pozicioni nr.1.3.01 është kërkuar furnizimi dhe mveshja e dyshemesë në zyre më laminat të prodhuesit“ Tarkett” tek pozicioni 1.4.02 furnizim dhe mveshja e korridoreve me linoleum natyral “ Tarkett”.

Tek pjesa 1.6.0. Punët ndërtimore me zanate pozicioni 1.6.03. është kërkuar furnizim dhe montim i dyerve për zyra të prodhuesit Horman oit, tek pjesa 2.1.0 Rrjeti gypor dhe trupat ngrohës dhe



fthës poz.2.1.019 është kërkuar Ventilator, konvektorët për montim në dysheme me filtër të ajrit, ventilatorin, enën për largimin e kondenzatit, termostatin komplet me elementet përcjellëse-prodhim Sabiana - Itali

Me përcaktimin e emrit të prodhuesit dhe origjinës të këtyre mallrave, mund të favorizohen prodhuesit e caktuar dhe në të njëjtën kohë diskriminohen prodhuesit tjetër. Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që produkti të jetë i kualitetit të lartë dhe mund të referohet një standardi vendor, European ose ndërkombëtar, por nuk lejohet assesit të kërkojë që origjina e këtyre pajisjeve të jetë nga ndonjë vend i caktuar si dhe nuk është e lejuar që të kërkojë nga ndonjë prodhues i caktuar.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për prodhues të caktuar e në të njëjtën kohë të diskriminojë Operatorët tjerë ekonomik, si dhe të mos caktoj kërkesa të cilat do të pengonin operatorët ekonomik për të dorëzuar tenderët e tyre.

Autoriteti kontraktues duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur se në Deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve mungon data, numri i prokurimit si dhe klasifikimi (FPP) , praktika këto jo të mira dhe në kundërshtim me LPP-në.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **28** Specifikimet teknike, nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare, dhe nenin **71** Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, me nenin **7** Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve dhe nenin **23** Kriteret e Përzgjedhjes e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!